

**Lenda: Gjetjet, analiza dhe rekomandimet e GENL në tematikën:  
3.5: Eficienca, Aksesit në shërbimet e sistemit të drejtësisë**

**1. Z. Gerti Shella, (Dr. i Shkencave), ekspert i eficientës gjyqësore, INFOCIP**

- a. Forcimi në mënyrë sinjifikative të eficientës së sistemit të drejtësisë duke adresuar kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, numrin e lartë të backlogut nëpërmjet një qasjeje strategjike.*
- b. Adresimi i backlogut (numrit të lartë të çështjeve të pazgjidhura) i krijuar në të gjitha nivelet e gjykatave veçanërisht në nivelin e apelit por edhe në shkallët e para – krahasimi me standartet e CEPEJ dhe mbështetja me burime e Planit të veprimit përkatës.*
- c. Zbatimi i hartës së re gjyqësore dhe menaxhimi i problematikave të krijuara veçanërisht në vakancat e sistemit të drejtësisë;*

**2. Z. Alket Jaupi, (Dr. i Shkencave) Perfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit**

- d. Aksesit i qytetarëve në sistemin gjyqësor si dhe cilësia e shërbimeve gjyqësore dhe prokurorisë ndaj qytetarëve.*
- dh. Mbledhja e të dhënave bazuar në metodologjinë CEPEJ dhe treguesit e efikasitetit sipas standarteve të vendeve të BE-së;*
- e. Ngritja e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, ndërlidhje e sigurt me bazat e tjera të të dhënave dhe sistemeve që do krijohen, shpërndarja më e mirë e çështjeve tek gjyqtarët dhe prokurorët.*

**3. Znj. Nadia Rusi, (Prof. Ass, Dr i Shkencave), Fakulteti Juridik, UT**

- f. Digjitalizimi i shërbimeve gjyqësore ndaj qytetarëve dhe avokatëve;*
- g. Ndihma juridike falas;*
- gj. Ndërmjetësimi*

*Ndërkohë, sekretariati teknik, I përbërë nga Znj. Elona Lipivani, Z. Ermal Jahaj dhe Znj. Nadia Guni mblodhën të dhëna lidhur me:*

- a. Performanca në drejtimin e prokurorive e gjykatave dhe problematikat përkatëse, duke përfshirë burimet njerëzore ndihmëse për të ulur ngarkesën, burime financiare, etj..*
- b. Vlerësimi dhe promovimi I magjistratëve duhet të forcohet nëpërmjet rregullave të qarta përsa i përket eficientës së magjistratëve, një balancë më e mirë midis kritereve cilësore dhe atyre sasore dhe rritja e transparencës së procesit.*

*Për të mundësuar një lexim sa më të thjeshtuar të materialit, gjetjet dhe kontributet e INFOCIP renditen me poshte te parat, sipas pikave që i ka renditur Kuvendi ne tematikën 3.4. INFOCIP rezervon te drejten per te terhequr kontributin e vet, nese gjetjet e propozuara preken, tjetersohen apo keqperdoren nga GENL apo nga Kuvendi gjate procesimit te tyre të metejshem.*

**Me poshte gjeni analizen dhe rekomandimet e INFOCIP (Gerti Shella)**

## Hyrje

Më 22 Korrik 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi amendamentet kushtetuese të Reformës në Drejtësi<sup>1</sup>. Ato u pasuan nga miratimi i ligjeve të Reformës, proces i cili përfundoi në vitin 2017<sup>2</sup>. Misioni i Reformës në Drejtësi, i shpallur si në dokumentacion parlamentar ashtu dhe në atë qeveritar (të paktën në dy SND) ka qenë sigurimi i një sistemi gjyqësor **efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent**.

**Efektiviteti dhe Efikasiteti** gjyqësor implikojnë një shërbim gjyqësor të shpejtë dhe cilësor ndaj publikut, përmes aksesit të shtuar në drejtësi. Të dhënat e krahasuara nga viti 2016 e në vijim sugjerojnë qartësisht Eficienca gjyqësore ka pësuar përkeqësim, sidomos në gjykimin në shkallë të dytë (Apel).

Implementimi i Reformes në Drejtësi ishte/është parashikuar të kalojë në të paktën tre faza, secila e ndërlidhur më një Strategji Ndërsektoriale të Drejtësisë<sup>1</sup> (SND). Ndër problemet kryesore të evidentuara dhe të pranuar tashmë zyrtarisht janë vonesat e theksuara gjyqësore, stoku gjyqësor (backlog) në rritje.

## Analiza për pikat “a”, “b” dhe “c”, (nga. Dr. Gerti Shella)

### **Çështjet e prapambetura në Gjykata**

Që prej vitit 2017, stoku i dosjeve në pritje të shqyrtimit gjyqësor ka pësuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2022 ai arriti në 132008 dosje në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Në vitin 2023 stoku u rrit në 140 mijë dosje, duke shënuar një rekord historik. Të dhënat për vitin 2024 sugjerojnë një zvogëlim të stokut në Gjykatën e Lartë (18665), por rritje në të gjitha gjykatat e tjera, sidomos në Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm (41.200) dhe Apelin Administrativ (23862).

Stoku i dosjeve nënkupton vonesa në shqyrtimin gjyqësor, përkeqësim të kushteve të punës për gjyqtarët dhe personelin ndihmës dhe ulje domethënëse të aksesit në drejtësi për qytetarët dhe subjektet e tjera që janë përdorues të gjykatës. Sipas dokumentave zyrtare të KLGJ, gjatë vitit 2023, qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave duke sjellë një ulje prej 9.5 % të çështjeve të reja të regjistruara, krahasuar me vitin paraardhës. Drejtësi e vonuar është drejtësi e munguar dhe stoku gjyqësor ka potencialin për të dëmtuar seriozisht besimin tek gjykatat dhe Drejtësia.

Ankimet në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese për tejkalim të afatit të gjykimit të arsyeshëm janë shtuar gjatë tre viteve të fundit. Gjykata Kushtetuese ka gjetur në shkelje Gjykatën e Lartë për mënyrën e trajtimit të këtyre lloj ankesave, duke implikuar mos garantimin e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor nga Gjykata e Lartë. Ankimet gjyqësore në GJEDNJ për vonesa gjyqësore tej afatit të arsyeshëm gjithashtu janë shtuar. Në 12 tetor 2021, GJEDNJ dënoi shtetin shqiptar me 3500 Euro, plus shpenzimet gjyqësore për vonesat e shkaktuara në shqyrtimin gjyqësor ndaj dy shtetasve të saj (Barra dhe Kola Vs. Albania).

### **Organika e gjyqësore dhe personeli ndihmës**

---

<sup>1</sup> Faza I (2016-2020), Faza II (2021-2025) dhe Faza III (2024-2030), ecila konsiderohet si faza e fundit e reformes dhe synon përmirësimin e mëtejshëm të kuadri ligjor në përputhje me *acquis të BE*, eliminimin e backlog-ut, rritjen e cilësisë së shërbimeve, për një drejtësi në standartet e BE.

Vihet re qartësisht një lidhje shkak-pasojë midis numrit të gjyqtarëve dhe eficiencës gjyqësore. Në nëntor 2023 Gjykata e Lartë kompletoi trupën e saj me 19 gjyqtarë. Ajo ka 17 gjyqtarë efektivë dhe 25 këshilltarë ligjore (7 ndihmës magistratë dhe 18 këshilltarë ligjorë) nga 38 vende gjithsej. Gjatë 3 viteve të fundit Gjykata e Lartë e RSH ka mundur të reduktojë stokun gjyqësor. Në fund të vitit 2024 ajo raporti një stok (backlog) prej 18665 çështjesh në pritje të gjykimit, nga 31827 që ajo kishte në vitin 2022.

Gjykata e Lartë ka mbi 3 vjet që tejkalon standardin ndërkombëtar, duke arritur për 2024 një normë të likuidimit të çështjeve prej 312% dhe me një ngarkesë për çdo gjyqtar me një shifër rekord, afro 449 vendime në vit<sup>2</sup>. Megjithatë, nese vijohet të mbahet ky ritëm, do të duhen sërish rreth 3 vjet të tjera vetëm për reduktimin e stokut aktual (rakordimi i fundit: Dhjetor 2024), pa llogaritur prurjet e reja.

Gjykata e Lartë ka marrë disa masa për dekurajimin e rekurseve, sidomos nga institucionet publike. Po ashtu, GJL ka rikthyer në shkallët më të ulëta të gjykimit një numër të lartë çështjesh civile, veprim i cili, teksa kontribuon në reduktimin e stokut të saj, rrit artificialisht prurjet në gjykatat e shkallëve më të ulëta.

\*\*\*

Mungesa e efikasitetit në gjykatat e apelit vijon të mbetet problem më shqetësues. Vonesat në shqyrtimin gjyqësor, arsyetimin e vendimit dhe numri rekord çështjesh të mbarura, kanë vënë në vështirësi serioze funksionimin e Gjykatës së Apelit Të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit<sup>3</sup>.

Mungesat në burime njerëzore (gjyqtarë dhe stafe ndihmëse), infrastrukture fizike, përfshirë sistemet e menaxhimit të çështjeve janë ndër shkaqet kryesore të identifikuar për dobësimin e treguesve të eficiencës<sup>4</sup> në shkallën e dytë të gjykimit.

Sipas KLGJ, pjesa më e madhe e gjykatave funksionon me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve; në nivel kombëtar vetëm 60.5% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023. Ky tregues është përmirësuar gjatë vitit 2024, por vonesa në shqyrtimin e aplikimeve nga KLGJ për plotësimin e vakancave kanë krijuar vështirësi dhe kritika.

Mungesat më të ndjeshme konstatohen në trupën gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP). Deri para aktivizimit të Reformës së Rretheve Gjyqësore, asnjë gjykatë Apeli (6 gjithsej në juridiksionin e përgjithshëm) nuk plotësonte kushtin ligjor për të funksionuar me të paktën 10 gjyqtarë (neni 15/4/ pika b, ligji Nr. 98/20165. Trupa gjyqësore në Apel, deri në vitin 2022 u reduktua mbi 60% si pasojë e procesit të vetting-ut.

Në momentin e aktivizimit të Reformës së Rretheve Gjyqësore në 1 Shkurt 2023, vetëm 24 gjyqtarë kishin mbetur në detyrë në të gjitha gjykatat e apeleve të J.P.. Ata u grupuan të gjithë në GJAJP Tiranë. Kjo gjykatë duhet të funksionojë me 78 gjyqtarë, sipas organikës së saj të miratuar. Gjatë vitit 2024 numri u rrit në 28 gjyqtarë, ndërkohë që mungojnë akoma 50 gjyqtarë.

Stoku gjyqësor në GJAJP arriti në shifrën rekord prej 41200 dosjesh në pritje të

<sup>2</sup> analiza vjetore 2024, fjala e kryetarit të GJ, Z. Sokol Sadushi, Link: <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/lajme/fjalime/deklarate-per-median-e-kryetarit-te-gjykes-se-larte-z-sokol-sadushi-dhjetor-2024>

<sup>3</sup> Progres Raporti i BE për Shqipërinë, 2024, fq.31, "Eficiencia: Link: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf)

<sup>4</sup> INFOCIP, "KOHËZGJATJA GJYQËSORE NË APEL dhe AFATET E GJYKIMIT TË ARSYESHËM 2016-2023",

<sup>5</sup> PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021)

gjykimit në muajin nëntor 2024. Ky numër mund të jëtë disa qindar dosja më i lartë për gjithë vitin 2024.

Ndërkohë, Gjykata e Apelit Administrativ, GJAA (me seli në Tiranë) është gjithashtu e prekur nga fenomeni i vonesave gjyqësore; në vitin 2022 numëroheshin 21166 dosje në pritje të shqyrtimit, kurse në vitin 2023, ky numër arriti në 23056. Në fund të vitit 2024, stoku u rrit në 23862. Për herë të parë GJAA plotësoi trupën gjyqësore me 13 gjyqtarë në tetor 2024 (dy gjyqtarë të caktuar së fundmi), duke plotësuar në këtë mënyrë organikën e miratuar. Sipas të dhënave zyrtare, Norma e Rendimentit (NR) për gjyqtar në këtë Gjykatë për vitin 2023 ishte afërsisht 206 çështje të shqyrtuara për gjyqtar. Ky tregues është gjithsesi 1/3 më i ulët krahasuar me GJAJP Tiranë, por në këtë rrethanë duhet mbajtur parasysh fakti se gjykimi në GJAA bëhet gjithmonë në trupë kolegjiale prej 3 ose 5 gjyqtarësh.

GJAA ka nevojë për një numër të dyfishuar gjyqtarësh (25) për të adresuar efektivisht stokun gjyqësor. Plotësimi i numrit të gjyqtarëve (13) ka siguruar vetëm që prurjet vjetore të balancohen me çështjet e vendimuara brenda atij viti, por reduktimi i stokut aktual është një sipërmarrje e pamunduar për t'u adresuar pa shtuar numrin e gjyqtarëve.

Kërkesa e bërë nga trupa gjyqësore e kësaj gjykate për ndryshime ligjore që lejojnë gjykimin me një gjyqtar në çështje të caktuara administrative në Apel ka potencialin të çbalancojë parimet dhe kriteret ligjore sa i takon shqyrtimit të ankimit në shkallë të dytë nga një trupë gjyqësore kolegjiale.

\*\*\*

Gjykata e Posaçme e Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin ka një organikë prej 10 gjyqtarësh efektive, nga 11 të miratuar. Ajo ka tregues pozitivë për evadimin gjyqësor brenda afatit 9 mujor që parashikon ligji. Mbartjet në fund të vitit raportohen vetëm për efekt të periudhës “dritare” dhe nuk janë reale.

Infrastruktura e sallave të gjykimit dhe e zyrave të gjyqtarëve është e plotësuar. Megjithatë, ka mangësi në infrastrukturë mbështetëse për disa funksione të posaçme që ligji i ngarkon kësaj gjykate. Aktualisht po punohet për adresimin e tyre.

Ndërkohë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin ka 16 gjyqtarë të miratuar në organikë, por vetëm 9 prej tyre kanë qenë të përhershëm nga viti 2023; pjesa tjetër janë caktuar nga skema e delegimit që ka menaxhaur KLGJ. Kjo gjykata ka tregues pozitivë për evadimin e shqyrtimit gjyqësor brenda afatit ligjor. Ngareksa për gjyqtar është relativisht e ulët, krahasuar më mesataren e gjykimit në shkallë të parë. Problem i mungesës së gjyqtarëve në këtë gjykatë janë gjithashtu kriteret ligjore të pranimit, që janë të njëjta si ato për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ (7 vjet përvojë sipas nenit 47/4, i Ligjit Nr. 96/20166 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSH”.) Magjistratët e rinj të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës nuk kualifikohen për të mbushur vakancat në këtë gjykatë.

\*\*\*

Gjykatat e rretheve gjyqësore, gjithashtu, u prekën nga procesi i implementimit të hartës së re gjyqësore. Më datë 30.04.2023, ndërprejnë veprimtarinë e tyre gjykatat e rretheve gjyqësore Mat, Kavajë, Lushnje, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. Në vijim, më datë 01.05.2023 filluan funksionimin gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë,

<sup>6</sup> Shfuqizuar nënë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020

Kukës, Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan, Sarandë dhe Vlorë (13 gjykata).

Gjatë vitit 2023, KLGJ emëroi në mënyrë të përhershme, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore 41 magjistratë, të rinj. Gjatë vitit 2023 keto gjykata punuan me 56% të trupes gjyqësore që iu është caktuar me dekret (132 gjyqtare efektive nga 235 gjyqtare të miratuar në organike). Në vitin 2024, u shtuan në sistem vetëm 32 gjyqtarë të rinj në sistem, të cilët u shpërndanë mes gjykatave të rrethit dhe atyre administrative të shkallës së parë. Viti 2025 ka nisur me mungesa që arrijnë deri në 1/3 e totalit të trupës gjyqësore që duhet të kenë këto gjykata.

Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, më e madhja në vend, e mbylli vitin 2024 me 54 gjyqtarë efektive, nga 80 që ka të miratuar me dekret në organikën e saj. Dhoma civile e kësaj gjykata arriti të evadonte gjatë vitit 2024 8428 gjykime themeli, por raportoi për 34684 dosje të mbartuara për vitin 2025. Ndërkohë, sipas të dhënave të disponuar për efekt të kësaj analize, gjatë vitit 2024 u vendimuan gjithashtu 8134 çështje<sup>7</sup>.

\*\*\*

*Procesi i vetting-ut vlerësohet si shkaku kryesor i mungesave/vakancave në trupën gjyqësore. Nga 8 shkurt 2018 kur nisi procesi i vetting-ut<sup>8</sup>, deri në Dhjetor 2024, ku ai u konsideruar i mbyllur në shkallë të parë, nga 805 gjyqtarë, prokurorë dhe ndihmës ligjorë që iu nënshtruan procesit kalimtar të rivlerësimit, vetëm 373 prej tyre arritën të kalonin me sukses filtrat e verifikimit.*

Largimet kanë qenë më të mëdha në rradhët e gjyqtareve krahasuar me ato të prokurorëve. Nga 407 gjyqtarë që iu nënshtruan vetting-ut, u konfirmuan në detyrë 169 prej tyre ose 41% e totalit dhe u shkarkuan 147 të tjerë ose 36% e totalit. Ndërkohë, 91 gjyqtarë u larguan nga procesi përmes dorëheqjeve. Nga rradhët e 331 prokurorëve u konfirmuan 171 ose 51% e totalit dhe u shkarkuan 115 ose 34% e totalit. 45 prokurorë të tjerë u larguan përmes përgjithësisht përmes dorëheqjeve.

\*\*\*

Prurjet nga Shkolla e Magjistraturës kanë qenë të pamjaftueshme për të balancuar largimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në vitin 2023, janë emëruar 41 magjistratë të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023. Në vitin 2024, u shtuan vetëm 32 gjyqtarë të rinj në sistem, pas përfundimit me sukses të vitit akademik 2023-2024 në Shkollën e Magjistraturës<sup>9</sup>. Gjatë vitit akademik 2024-2025<sup>10</sup> kanë filluar studimet në vitin e parë të Formimit Fillestar 62 studentë, nga të cilët vetëm 20 janë kandidatë për gjyqtarë<sup>11</sup>.

Magjistratët e dalë nga bankat e Shkollës së Magjistraturës nuk kualifikohen për të zëvendësuar vankancat në Apel për shkak të kriterit ligjor të përvojës (7 vjet), që parashikon neni 47/4, i Ligjit Nr. 96/2016<sup>12</sup> “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe

<sup>7</sup> Urdhëra ekzekutimi janë 3579 urdhëra ekzekutimi, 178 kërkesa, 309 OJF, 59 Penale kërkesa me të demtuar, 4 Dosje ushtarake, 370 kërkesa penale, 1993 Kërkesa penale seance paraprake, 761 Penale themeli, 940 seance paraprake 940

<sup>8</sup> Ligj Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSH”.

<sup>9</sup> <https://klgj.al/2024/10/sot-me-date-3-tetor-2024-ne-ambientet-e-keshillit-te-larte-gjyqesore-u-organizua-ceremonia-e-betimit-te-magjistrateve-profili-gjyqtar-te-cilet-kane-perfunduar-shkollen-e-magjistrat/>

<sup>10</sup> <https://www.magjistratura.edu.al/sq/lajme/njoftime/nis-viti-akademik-2024---2025>

<sup>12</sup> Shfuqizuar nënë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020

Prokurorëve në RSH”. Ky kriter ligjor mund të ketë nevojë për rishikim në kushtet e krizës aktuale të stokut gjyqësor në rritje.

Verifikimi paraprak i kriterëve dhe kushteve formalo-ligjore, pasurisë dhe figurës për magistratët e rinj konsiderohet gjithashtu një hallkë e cila duhet adresuar përmes amendimeve ligjore. Verifikimi i tyre ndodh para pranimit në Shkollën e Magistraturës<sup>13</sup>, në bashkëpunim me ILDKPI dhe institucione të tjera ligjzbatuese<sup>14</sup>, si dhe pas diplomimit (nga KLGJ para emërimit). Neni 32 i ligjit Nr. 96/2016, të ndryshuar, duhet të konsiderohet për amendime shtesë, për të përkrahur nevojat për shtimin e trupës gjyqësore në sistem.

\*\*\*

Problematike konsiderohen vonesat e KLGJ në plotësimin e vakancave me magistratë të rinj, duke mos-reflektuar në vendimarrjen e saj urgjencën që shfaq sistemi për plotësimin e numrit të gjyqtarëve. KLGJ “emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve” (neni 61, ligji 115/2016<sup>15</sup>).

Këshilli Lartë Gjyqësor bashkëpunon me Shkollën e Magistraturës për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë në pajtim me këtë ligj dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe emëron gjyqtarët pas diplomimit në Shkollën e Magistraturës (neni 85 i ligjit 115/2016).

Ka patur raste të depozitimit të padive në gjykatën administrative nga ana e magistratëve kundër KLGJ për mos-emerim, të cilat ekzpozojnë një dimension që bien ndesh me interesin publik për një drejtësi pa vonesa, shkaku kryesor i të cilave janë gjyqtarët e pamjaftueshëm në sistem.

Procesi vendimarrës i KLGJ për të garantuar flukse hyrëse të mjaftueshme për gjyqtarë të rinj në sistem duhet të thjeshtësohet. Caktimi i afateve më të shkurtra për vlerësimin e kandidaturave dhe caktimin e tyre në detyrë nga KLGJ duhet të përcaktohen me ligj, ose të jenë pjesë e një rregullore të rishikuar.

Afatet në emërimin në detyrë të magistratëve/gjyqtarëve nga KLGJ duhet të monitorohen dhe të ekspozohen për efekt të rritjes së llogaridhënies institucionale dhe publike. Vonesat vendimarrëse të KLGJ duhet adresuar me mjete efikase ligjore dhe/ose administrative, në sfondin e parimit të kontrollit të pushteteve, duke respektuar sidoqoftë parimin e pavarësisë institucionale. Caktimi i afateve prekluzive në ligjin 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, sa i takon kohës në dispozicion të KLGJ për procesin e emërimit në sistem të magistratëve të rinj, por edhe të gjyqtarëve me përvojë që lëvizin vertikalisht brenda sistemit konsiderohet i domosdoshëm

\*\*\*

Ndihmësat ligjore janë burime njërzore të domosdoshme për efikasitetin gjyqësor. Neni 42<sup>16</sup> i Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në RSH” përcakton se numri i tyre “nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i

<sup>13</sup> Neni 32 “Verifikimi i pasurisë dhe figures (ndryshuar pikat 2, 4, 6 , shtuar pikat 4/1 dhe 6/1 me ligjin nr. 50/2021, datë 23.3.2021) LIGJ Nr. 96/2016 PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË RSH (Shfuqizuar me vendimin e GJK nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020; nr. 50/2021, datë 23.3.2021)

<sup>14</sup> neni 32, par.2 vijon: “...nga prokuroria, gjykata, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit

<sup>15</sup> Ligji 115/2026 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË” ( shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 16.5.2017 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, ndryshuar me ligjin nr. 47/2019, datë 18.7.2019)

<sup>16</sup> ndryshuar titulli, pika 1 e 10, shtuar pika 1/1, me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021

gjqqtarëve”. Aktualisht, në shumicën e gjykatave ka më pak ndihmësa ligjorë se sa gjyqtarë. GJAJP ka aktualisht 22 ndihmësa, pra më pak se sa ka gjyqtarë (28 përditësimi i muajit Janar 2025 bërë nga INFOCIP). Shtimi i ndihmësave ligjorë është i domosdoshëm për të rritur efektivitetin e gjykatave. Edhe sikur të adoptohej qasja praktike, sipas së cilës, GJAJP të kishte 78 ndihmëse, pavarësisht se për momentin trupa është e përbërë nga 28 gjyqtarë, kjo do të ishte një ndihmesë e madhe pasi cdo gjyqtar mund të kishte de-fakto dy ndihmësa në dispozicion.

Dispozitat aktuale kanë nevojë për rishikim për të krijuar gjithashtu një raport më të lartë për gjykatat e apelit, në kushtet kur ato përballen me nivele rekord të stokur gjyqësor. Edhe Gjykata e Lartë mund të ketë nevojë për të paktën dy ndihmësa për gjyqtar, edhe sikur vetëm për një periudhë tranzitore 5 vjeçare.

Numri i aplikimeve në Shkollën e Magjistraturës për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë mbetet i ulët. Për më tepër, kuotat e miratuara për këtë pozicion kanë qenë gjithashtu të ulëta, konkretisht vetëm 15 për vitin akademik 2023- 2024<sup>17</sup>;

Provimi i Shkollës së Magjistraturës përpilohet i njëjtë si për magistratët ashtu edhe për kategorinë e ndihmësave ligjore. Kurrikula e pa-diferencuar ka ulur numrin e aplikimeve për ndihmës gjyqësor, pasi konkurrentët synojnë statusin e magistratit sa kohë që konkurrojnë me të njëtin program. Rishikimi i kuadrit ligjor për të diferencuar dhe lehtësuar kriteret e pranimit për ndihmësat ligjorë në Shkollën e Magjistraturës është i domosdoshëm.

Ndihmësat ushtrojnë funksionin e tyre pas një kualifikimi profesional 9-mujor. Që një ndihmës të bëhet magistrat në një kohë të dytë, do të duhet që ai/ajo të ndjekë nga e para (duke u pranuar filimisht përmes provimit) ciklin tre-vjeçar në Shkollën e Magjistraturës. Ndihmësave ligjorë mund t’ njihet me ligj e drejta të bëhen magistratë, një periudhë disa-vjeçare përvojë punë, pa kaluar nëpër të gjithë ciklin tre-vjeçari të ciklit të formimit në SHM, por vetëm përmes një cikël të përqëndruar kualifikimi disa mujor dhe marrjes së provimit.

## **Infrastruktura gjyqësore**

*Infrastruktura gjyqësore në RSH në përgjithësi i pëgjigjet keq nevojave aktuale. Infrastruktura fizike është e pamjaftueshme në tërësinë e saj. sidomos në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Funksionet arkivore janë të riskuara ose të kompromentuara. Infrastruktura dixhitale është e mangët.*

Gjykata e Lartë e RSH zhvillon aktivitetin në godinën ekzistuese, e cila ka vetëm dy salla gjykimi dhe një sallë këshillimi. Do ishte optimale nese çdo kolegji do të kishte sallën e vet të gjykimit dhe të këshillimit. Kjo do të rriste efektshmërinë e gjykimeve si dhe do të lejonte më shumë gjykime në njësinë e kohës. Ndërkohë, janë miratuar planet për një godinë të re bashkëkohore ku do të akomodohet GJL në të ardhmen, edhe pse punimet nuk kanë nisur ende. Mjediset aktuale të GJL për arkivimin e dosjeve gjyqësore janë të pamjaftueshme.

Godina në të cilën ushtron aktivitetin GJAJP në Tiranë ka 28 zyra gjyqtarësh dhe 7 salla. Godina është e papërshtatshme për të akomoduar 78 gjyqtarë, edhe sikur kjo mundësi të ekzistonte. Pas aktivizimit të Reformës së Rretheve Gjyqësore, KLGJ pezulloi skemën e delegimit në Apel. Një ndër arsytet besohet se ka të bëjë me pamjaftueshmërinë e infrastrukturës së kësaj gjykate, godina e së cilës ka qenë më parë një repart zjarrfikës, që u përshtat si gjykatë. Edhe katër gjyqtarë të tjerë pritet t’i shtohen trupës gjyqësore së GJAJP Tiranë, ndërkohë që akomodimi i tyre me zyra

<sup>17</sup> Raporti vjetor I KLGJ për vitin 2023, fq 6, link: <https://klgj.al/ep-content/uploads/2024/04/RAPORT-VJETOR-2023.pdf>

mbetet një sfidë.

Shtatë salla gjykimi që përdoren aktualisht në GJAJP janë të pamjaftueshme për një trupë gjyqësore më të madhe se sa 25 gjyqtarë. Ndryshimet ligjore për gjykimin monokratik të masave të sigurimit në apel, nuk kanë dhënë efektin e synuar në rritjen e eficiencës, kryesisht për shkak të pamjaftueshmërisë së sallave të gjykimin. Gjatë vitit 2024, dhoma penale e GJAJP ka patur rreth 11 gjyqtarë, të cilët kanë në dispozicion vetëm 4 salla për të realizuar gjykimet për ankim të masave të sigurimit. Nëse do të kishte patur 11 salla, secili prej tyre do të mund të gjykonte në mënyrë të pandërprerë, një apo dy ditë të javës së punës.

Infrastruktura e pamjaftueshme fizike kompromenton gjithashtu funksionet arkivore dhe menaxheriale. Shërbimi ndaj qyterarëve që kërkojnë dosjet e tyre gjyqësore është përkeqësuar, sipas pasojë e mungësës së hapësirës së arkivimit.

Kjo krizë për zyra, salla dhe hapësirë për administrimin e dosjeve ndodh në një kohë kur 5 godinat ekzistuese të gjykatave të Apelit (Shkodër, Vlorë, Korçë, Durrës, Gjirokastrë) kanë mbetur bosh pas Reformës së rretheve Gjyqësore. Me përjashtim të gjykatave të apelit të Durrësit dhe Tiranës, godinat e tjera kanë qënë moderne, ndërtuar sipas standarteve europiane me fonde të BE.

Abrogimi i skemës aktuale në fuqi në kuadër të Reformës më të fundit të Rretheve Gjyqësore dhe rihapja e gjykatave të Apelit të J.P. Shkodër, Vlorë dhe Korçë do të restauronte aksesin dhe do të eliminonte nevojën për salla gjykimi dhe dhoma gjyqtarësh.

Një skemë e re delegimi mund të konceptohet paraprakisht për ri-hapjen e këtyre gjykatave për efekt të akomodimit të gjyqtarëve nëse numri i tyre kalon 30 në GJAJP. Kjo skemë mund të synojë hapjen sekuenciale të gjykatave të apelit, duke filluar më parë me Shkodrën, ose Vlorën, dhe pastaj edhe me Korçën.

Parashikimet ligjore në fuqi për numrin minimal të gjyqtarëve në një gjykatë Apeli kanë nevojë të amendohen, për t'ju përgjigjur nevojave në të cilën ndodhet sistemi gjyqësor. Do ishte optimale që një gjykata apeli e JP në një rreth gjyqësor të lejohet të funksionojë edhe me 7 gjyqtarë për një periudhë tranzitore 3-5 vjeçare, nga 10 që parashikon aktualisht ligjislacioni në fuqi.

\*\*\*

Gjykata e Apelit Administrativ, me seli në Tiranë gjithashtu ushtron aktivitetin në një godinë të përshtatur dhe të rikonstruktuar, por që fillimisht ka qënë ndërtuar si konvikt studentor. Përshtatja e saj si godinë gjykate është realizuar me cilësi. Megjithatë, në kushtet kur kjo gjykatë mund të zgjerohet në organikë, infrastruktura ekzistuese do të jetë një kufizim real për akomodimin e gjyqtarëve të rinj dhe ndihmësave të tyre.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka aktualisht 10 nga 11 gjyqtarë që parashikon organika e saj. Ajo ka infrastrukture të kompletuar me zyra për gjyqtarë dhe salla gjykimi. Ngarkesa e saj vjetore konsiderohet normale, pa backlog. Mungojnë gjithsesi mjediset e përshtatshme për ushtrimin e aktiviteve specifike që kësaj gjykata i njihen me ligj.

\*\*\*

Pas reformës së rretheve gjyqësore, 22 gjykata rrethesh u konsoliduan në vetëm 13 gjykata. Ato u vendosën në qytete qendër qarku, me përjashtim të Sarandës. Disa gjykata kanë infrastrukturë të vjetëruar ose të pamjaftueshme, të cilat nuk ofrojnë kushte për respektimin e parimit të solemnitetit. Administrimi gjyqësor shfaq problem, për shkak të hapësirave të pamjaftueshme.



Gjykatat e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është e shpërndarë në dy godina, respektivisht për dhomën penale dhe atë civile. Dhomat regjistrojnë të dhënat e tyre në regjistra të veçuar. Zhvillimi i gjyqeve në sallat e gjyqtarëve vijon të mbetet një praktikë dominuese në Dhomën Civile.

## **Afatet e gjykimit në Apel**

Afatet gjykimit kanë njohur vetëm rritje që nga momenti i fillimit të reformës në drejtësi. Situata më e rënduar haset në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithëm (GJAJP) dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ (GJAA), të dyja gjykata kombëtare me seli në Tiranë.

Problem serioz vijon të mbetet mos-arsyetimi i vendimeve nga gjyqtarët. Ky është tregues i ngarkesës të cilën ata përballen në punën e tyre të përditshme. Shkelja e afateve të arsyetimit të vendimit është kusht i mjaftueshëm ligjor që ILD të vlerësojë performancën profesionale të gjyqtarëve. Megjithatë, një veprim i tillë do të penalizonte më tej trupën e pakët gjyqësore që përballet me ngarkesa të jashtëzakonshme.

Reforma e rretheve gjyqësore e cila u implementua në vitin 2023, nuk ka sjellë rezultat e pritura sa i takon reduktimit të stokut në GJAJP. Stoku ka vijuar të rritet me ritme konstante, duke kaluar 41 000 dosje në tetor 2024.

Sa i takon afeteve të gjykimit në Gjykatën e Apelit Administrativ, ato janë dyfish të shkelura, për shkak të parashikimeve eksplicite që përmban ligji kuadër 49/2012, i ndryshuar. Neni 48, i ndryshuar përcakton shprehimisht se Gjykata e Apelit Administrativ “shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi<sup>18</sup>”.

*Sipas KLGJ, në 2014 numri i çështjeve të prapambetura në këtë gjykatë ishte afërsisht 6000 çështje; në vitin 2023 numri u rrit në 23.056 çështje...Bazuar në treguesit e mësipërm, për zgjidhjen e një çështjeje, tendenca është që, në kushtet aktuale, duhen mesatarisht 5326 ditë<sup>19</sup> (14.6 vjet).*

GJAA renditet e para ndër gjykatat shqiptare sa i takon tejkalimit të afatit të gjykimit të arsyeshëm për çështjet që merr në shqyrtim. Sipas përcaktimeve në nenin 399/2<sup>20</sup>, “në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë”. Kjo gjykatë, zgjidh pak ankime për mosmarrveshje administrative, por konsumon shumë shkelje të drejtave kushtetuese shtetasve sa i takon procesit të rregullt ligjor.

## **Tejkalimi i afateve të gjykimit të arsyeshëm.**

Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ka rëndësi themelore për gjykimin civil, administrativ dhe penal. Ai përbën një nga elementët e procesit të rregullt ligjor dhe garantohet nga Kushtetuta<sup>21</sup> dhe KEDNJ<sup>22</sup>. Respektimi i parimit të gjykimit pa vonesa tej një afati të arsyeshëm është kriter përcaktues për efektivitetin e gjykimit<sup>23</sup>.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, afatet e gjykimit të arsyeshëm u ri-përcaktuan në

<sup>18</sup> ligji 49/2012. Neni 48 “Ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit” (Shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 49/2021, datë 23.3.2021)

<sup>19</sup> fq 10, Strategjia Kombëtare për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata 2022-2027, KLGJ

<sup>20</sup> neni 399/2 “Afati i arsyeshëm”, KPC, Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017

<sup>21</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 42, paragrafi 2: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”

<sup>22</sup> Neni 6 i KEDNJ

<sup>23</sup> Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ

mënyrë shteruese në neni 399/2 të Kodit të Procedurës Civile<sup>24</sup> në vitin 2017. Tejkalmi i afatit të arsyeshëm është shkak ligjor i mjaftueshëm për të ngritur padi për dëmshpërblim në gjykatat vendase (në gjykatën e shkallës më të lartë<sup>25</sup>).

Gjykata e Lartë ka pranuar zyrtarisht ekzistencën e problemet në shqyrtimet gjyqësore që ajo realizon<sup>26</sup>. Janë dokumentuar rreth 90 ankesa janë depozituar që nga viti 2017 për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, për çështje në shqyrtim nga Gjykatë e Lartë<sup>27</sup>. Pothuajse të gjitha kërkesat janë rrezuar, duke ngitur pikëpyetje mbi efektshmërinë e legjislacionit që ka prodhuar Ligjvënësi për garantimin e të drejtave të shtetasve kur shkelen afatet e gjykimit të arsyeshëm.

Numrin më të lartë të shqyrtimeve tej një afati 2 vjecar e zënë rekursat administrative. KPC nuk ka përcaktuar një afat prekluziv për shqyrtimin e tyre në GJL (neni 399/2). Rekomandohet plotësimi i nenit 399/2 të KPC që kjo mangësi legislative të adresohet, duke e parashikuar këtë afat jo më shumë se 1 vit, bazuar në parimin e analogjisë.

Gjykata e Lartë ka regjistruar një numër rekord ankimesh që nga vitit 2018 në cilësinë e gjykatës kompetente për shkelje të afatit të gjykimit të arsyeshëm nga gjykatat e Apelit. Sipas të dhënave që ajo ka bërë publike, rezultojnë 82 ankime me objekt të veçantë “Shkelje e afatit të gjykimit të arsyeshëm”. Shumica e këtyre ankimeve janë rrezuar me argumentin se “vetting-ut ka ulur numrin e gjyqtarëve”.

Ky argumentim bie ndesh me arsyetimet e GJEDNJ, e cila, në çështjen çështjen Bara & Kola kundër Shqipërisë (Tetor 2021), thekson se “reformat nuk mund të konsiderohen rrethana objektive që bëjnë të pamundur shqyrtimin e çështjeve, të paktën brenda logjikës së nenit 6 të Konventës; kjo qasje do ta zhvendoste të gjithë barrën e tyre mbi shpatullat dhe në dëm të individëve”.

Ri-orientimi i praktikës së ndjekur nga Gjykata e Lartë duhet konsideruar një domosdoshmëri, pasi, nëse të drejtat legjitime të shtetasve (në rastin konkret janë të drejta themelore) shkelen nga autoriteti gjyqësor, atëherë kjo mund të pasojë nga ulja e besimit tek gjykatat dhe Pushteti Gjyqësor në tërësi. Gjykata e Lartë, pavarësisht se është maja e piramidës gjyqësore, duhet të linjëzoje vendimarrjen e saj me gjykatat që garantojnë të drejtat dhe liritë kushtetuese të shtetasve shqiptarë. Forcimi i parashikimeve ligjore për të orientuar Gjykatën e Lartë të përqëndrohet në unifikimin e praktikës gjyqësore është i domosdoshëm.

Gjykata Kushtetuese ka marrë ndërkohë një seri vendimesh të rëndësishme në këtë fushë, duke rrezuar vendimet e GJL për mos-konstatim të tejkalmimit të afatit të gjykimit të arsyeshëm në Apel. Vendimet e gabuara të Gjykatës së Lartë për çështje me objekt “tejkalmim i fatit të arsyeshëm” paradoksalisht kanë rritur kohëzgjatjen e shërbimit të drejtësisë si dhe kostot gjyqësore për qytetarët.

Nga vlerësimet e ndërmarra nga INFOÇIP rezulton një përkeqësim i ndjeshëm i treguesve sa i takon tejkalmimit të afateve të gjykimit të arsyeshëm në apel, sidomos në gjykimin civil të çështjeve të themelit. Përkeqësimi ka ardhur duke u thelluar që nga viti 2017 deri në 6-mujorin e parë<sup>13</sup> të funksionimit të GJAJP, e cila filloi nga puna në 1 Shkurt 2023. Kapaciteti gjykues i dhomave civile në apel ka ardhur në rënie vit pas viti. Në vitin 2016 këto dhoma arrinin të evadonin 6470 dosje civile themeli, kurse në vitin 2022 ky volum ra në vetëm 1729 dosje civile themeli (mbi 2/3 më pak).

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 <sup>14</sup>
------	------	------	------	------	------	------	------	--------------------

<sup>24</sup> Shtuar neni 399/2 me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017

<sup>25</sup> neni 399/3 dhe 399/4, Kodi i Procedurës Civile

<sup>26</sup> Rapori Vjetor 2023, gjykata e larte, Faqja 116, paragrafi 3. Link: [https://gjykata-media.s3.eu-central-1.amazonaws.com/RAPORTI\\_VJETOR\\_2023\\_S\\_GJYKATA\\_E\\_LARTE\\_9\\_2\\_2024\\_9d79a263c8.pdf](https://gjykata-media.s3.eu-central-1.amazonaws.com/RAPORTI_VJETOR_2023_S_GJYKATA_E_LARTE_9_2_2024_9d79a263c8.pdf)

<sup>27</sup> Burimi: Faqja Zyrtare e Gjykatës së Lartë. Link: <https://gjykataelarte.gov.al/sq/kerkesa-per-konstatimin-e-shkeljes-se-afatit-te-arsyeshem-te-gjykimit-per-ceshtje-te-gjykes-se-larte>

<b>CIVILE THEMELI TOTAL VENDIME</b>	<b>6470</b>	<b>6510</b>	<b>4983</b>	<b>3671*15</b>	<b>1493</b>	<b>1937</b>	<b>1729</b>	<b>641</b>
<b>TEJ AFATIT TE ARSYESHEM</b>	<b>57</b>	<b>90</b>	<b>367</b>	<b>783</b>	<b>478</b>	<b>926</b>	<b>940</b>	<b>502</b>
<b>Në %</b>	<b>0.9%</b>	<b>1.4%</b>	<b>7.4%</b>	<b>21%</b>	<b>32%</b>	<b>47.8%</b>	<b>54.3%</b>	<b>78.3%</b>

Lidhur me gjykimet për çështje PENALE themeli, në vitin 2016, tej kohezgjatjes 1-vjecare dilnin rreth 27% e totalit të dosjeve të shqyrtuara. Ndërkohë, në vitet 2021-2022, jashtë afatit 1-vjeçar dolën 44% e totalit të dosjeve penale të themelit. Në periudhën 1 Shkurt-31 Korrik 2023, (6-mujori i parë i punës së GJAJP Tiranë), jashtë afatit të arsyeshëm dolën 44% e totalit të çështjeve penale të themelit. Kapaciteti për evadimin e dosjeve ka rënë me më shumë se 2/3.

**Tab. 3**

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
<b>PENALE THEMELI TOTAL VENDIME</b>	<b>4569</b>	<b>4622</b>	<b>5048</b>	<b>2643</b>	<b>1193</b>	<b>1762</b>	<b>2307</b>	<b>1346</b>
<b>JASHTË AFATIT TE ARSYESHEM</b>	<b>1241</b>	<b>2240</b>	<b>2567</b>	<b>1118</b>	<b>409</b>	<b>787</b>	<b>1022</b>	<b>599</b>
<b>Ne %</b>	<b>27%</b>	<b>48%</b>	<b>51%</b>	<b>42.3%</b>	<b>34.2%</b>	<b>44.6%</b>	<b>44.3%</b>	<b>44.5%</b>

### **Përfundime dhe Rekomandime për pikat “a”, “b” dhe “c”,**

Mungesa e gjyqtarëve vlerësohet si shkak kryesor i vonësive gjyqësore në rritje, sidomos në GJAJP, Tiranë. Largimi i gjyqtarëve përmes procesit të vetingut, nuk është pasuar nga një strategji efektive për zëvendësimin e tyre.

Infrastruktura fizike e pamjaftueshme është gjithashtu një ndër shkaqet që cënon eficientësinë e gjykimit, me mungesë të zyrave për gjyqtarët dhe numër të paktë sallash gjykimi. Ndryshimet ligjore për të thjeshtëzuar gjykimin e masave të sigurimit në Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm me trupe monokratike (gjyqtar i vetëm), nuk kanë sjellë efektet e synuara për shkak të mungesës së sallave të gjykimit në godinën ku ushtron veprimtarinë GJAJP, Tiranë.

Mungojnë stafet ndihmëse ndërkohë që sistemi i menaxhimit të çështjeve është rudimentar krahasuar me nevojat që dikton stoku. Mungesa e sistemeve adequate që shërbejnë për menaxhimin e çështjeve gjyqësore krijon një vështirësi të shtuar. Automatizimi i procesit të mbartjeve është një domosdoshmëri në kushtet e krijuara. Formatet analoge të proceseve të punës ngadalësojnë menaxhimin, janë jo-efektive dhe nuk sigurojnë saktësinë e synuar në regjistrimin e të dhënave dhe prodhimin e statistikave të besueshme gjyqësore.

KLKJ miratoi një Strategji<sup>28</sup> për uljen e numrit të çështjeve të prapambetuar në gjykata por ajo nuk ofron zgjidhje se ku do të gjenden gjyqtarët që mungojnë në sistem. KLKJ pranon se numri i vendeve vakante në gjykata mbetet i lartë, për shkak të procedurave komplekse të procesit të rivlerësimit apo të vlerësimit të ankesave nga ILD-ja sipas ligjit në fuqi. Trupa gjyqësore parashikohet të shtohet rreth vitit 2027, kohë në të cilën kjo Strategji përfundon.

Ndryshimet ligjore të propozuara nga KLKJ për rritjen e eficientësisë prekin ligjin nenin 12, të ligjit 49/2012, të ndryshuar dhe/ose parashikime në Kodin e Procedurës Administrative. Ato duhen parë me kujdes, pasi kanë potencialin të kompromentojnë

<sup>28</sup> link: <https://klgj.al/ep-content/uploads/2024/05/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Uljes-s%C3%AB-Numrit-t%C3%AB-C%C3%ABShtjeve-t%C3%AB-Prapambetura-n%C3%AB-Gjykata-2024-2027.pdf>

cilësinë e gjykimit në Apelin administrativ, duke shkaktuar një problem të dytë madhor, krahas vonesave që vuajnë qytetarët.

### **Bazuar në sa më sipër, rekomandimet kryesore për pikat a, b, dhe c janë:**

1. Të rishikohet neni 47/4, i Ligjit Nr. 96/2016<sup>29</sup> “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSH”, duke u ulur në 5 vjet kriterin ligjor të përvojës së punës për të qenë gjyqtar në Apelin e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Apelin Administrativ, në kushtet e krizës aktuale të stokut gjyqësor dhe pamjaftueshmërisë së gjyqtarëve. Ndryshimi i kriterit ligjor mund të shoqërohet me dispozita kalimtare, efektive për një periudhë tre ose pesë vjeçare.
2. Të konsiderohet ndryshimi/amendimi i neni 32 i ligjit Nr. 96/2016, të ndryshuar, për të lehtësuar praktikën e verifikimit paraprak të magjistratëve të rinj me synim lehtësimin e pranimeve të reja në sistemin gjyqësor.
3. Procesi vendimarrës i KLGJ për të garantuar flukse hyrëse të mjaftueshme për gjyqtarë të rinj në sistem duhet të thjeshtësohet. Caktimi i afateve më të shkurtra për vlerësimin e kandidaturave dhe caktimin e tyre në detyrë nga KLGJ duhet të përcaktohen me ligj, ose të jenë pjesë e një rregullore të rishikuar.
4. Rekomandohet caktimi i afateve prekluzive përmes ndryshimeve në ligjin 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, sa i takon kohës në dispozicion të KLGJ për procesin e emërimit në sistem të magjistratëve të rinj, por edhe të gjyqtarëve me përvojë që lëvizin vertikalisht brenda sistemit përmes sistemit të promovimit të karrierës.
5. Të dyfishohet numri i ndihmësave ligjorë të cilët ofrojnë ndihmesën e tyre në të treja shkallët e gjykimit, duke e adresuar problemin përmes ndryshimeve ligjore. Rekomandohet ndryshimi i nenit 42 të Ligjit 98/2016 Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në RSH” duke e riformuluar dispozitën si më poshtë: *“numri i ndihmësave ligjore nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i numri të përgjithshëm të gjyqtarëve”*
6. Rekomandohet të rishikohet kuadri ligjor/rregullator ekzistues për të diferencuar dhe lehtësuar kriteret e pranimit për ndihmësat ligjorë në Shkollën e Magjistraturës.
7. Rekomandohen ndryshime ligjore për kualifikimin e ndihmësve ligjore si kandidatë për magjistratë nga Shkolla e Magjistraturës, duke u njohur të drejtën atyre pas një periudhë disa-vjeçare përvojë punë të mund të japin provimet për magjistratë, pa kaluar nëpër të gjithë ciklin tre-vjeçari të ciklit të formimit, por vetëm në një cikël të përqëndruar 1 vjeçar.
8. Parashikimet ligjore në fuqi për numrin minimal të gjyqtarëve në një gjykatë Apeli duhe të amendohen për një periudhë tranzitore 3-vjeçare, për t’ju përgjigjur në mënyrë adeguate kushteve të emergjencës gjyqësore. Do ishte optimale që një gjykata apeli në një rreth gjyqësor të lejohet të funksionojë edhe me 7 gjyqtarë, nga 10 që parashikon aktualisht ligjislacioni në fuqi. Rekomandohet ndryshimi i nenit 15/4/ pika b, ligji Nr. 98/2016<sup>30</sup>. “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË

<sup>29</sup> Shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr. 48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020

<sup>30</sup> PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021)

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021).

9. Oraganika gjyqësore e Gjykatës së Apelit Administrativ duhet të dyfishihet dhe numri maksimal prej 25 gjyqtarësh rekomandohet të caktohet në ligjin kuadër.
10. Numrin më të lartë të shqyrtimeve tej një afati 2 vjecar e zënë rekursset administrative. KPC nuk ka përcaktuar një afat prekluziv për shqyrtimin e tyre ne GJL (neni 399/2). Rekomandohet plotësimi i nenit 399/2 të KPC duke e parashikuar këtë afat me jo më shumë se 1 vit, bazuar në parimin e analogjisë.
11. Rekomandohet forcimi i parashikimeve ligjore sa i takon detyrimit të unifikimit të praktikës ligjore nga Gjykata e Lartë, sidomos në rastet kur konstatohet se vendimet e kësaj të fundit në një tematikë të caktuar rrezohen në Gjykatën Kushtetuese dhe në GJEDNJ.
12. Shkelja masive e të drejtës për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm ka potencialin të godasë besimin tek Reforma në Drejtësi. Të vlerësohet mundësia për parashikime ligjore që prioritarizojnë në shqyrtim gjyqësor çështjet që rrezikojnë të dalin jashtë afatit të gjykimit të arsyeshëm, për të shmangur rriskun e penalizmit me back-log shtesë të gjykatave të shkallë më të larta me çështje me objekt vonesat gjyqësore. Gjithashtu, ky filtrim i shërben në tërësi shtetit shqiptar për të mos u penalizuar në të ardhmen e afërt nga GJEDNJ
13. Kostot eventuale që mund të vijnë vijnë si pasojë e padive në gjykatën kompetente me objekt *“tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit”* të përballen nga një fond i posaçëm kontigjence për subjektet e dëmtuara nga zvarritjet gjyqësore, përmes parashikimeve në buxhetin që u shpërndahet gjykatave